# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| Nr. Rendor [1] | Data e kërkesës[2] | Objekti i kërkesës[3] | Data e përgjigjes[4] | Përgjigje[5] | Mënyra e përfundimit të kërkesës[6] | Tarifa[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | 03.06.2024 | Kerkoj informacion ne lidhje me vendimi nr. x, datë x.x.x. 1. Mbi ç'bazë ligjore dhe çfarë argumenti, u mor vendimi i sipercituar 2. Pse u rrezua kjo kerkese? 3.Vënien në dispozicion vendimit bashkë me argumentet përkatëse te rrezimit te kerkeses etj. | 26.06.2024 | Agjencia e Trajtimit të Pronave ushtron aktivitetin e saj në zbatim të dispozitave të ligjit 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave" i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij si : VKM nr. 222, datë 23.03.2016, "Për trajtimin e kërkesave për njohje të së drejtës së kompensimit të pronës", i ndryshuar, dhe VKM Nr. 223, datë 23.3.2016 " Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit | E pjesshme | Jo |

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesës
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | financiar e fizik për kompensimin e pronave”, i ndryshuar.<br><br>Nga hyrja në fuqi e ligjit nr 133/2015 deri më sot e gjithë vendimmarrja për trajtimin e kërkesave për njohje pronësie, apo për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare me të drejtë kompensimi të vlerësuar financiarisht, është kryer në zbatim të dispozitave të përcaktuar në aktet e sipërcituara.<br>Sa më sipër, ju informojmë se referuar nenit 12 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndyshuar, si dhe *sipas Ligjit Nr.9154, date 06.11.2003 "Per Arkivat", ne Nenin 64 është përcaktuar:* “*Dokumentet e pronësisë u shërbehen trashëgimtarëve të pronës, përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe institucioneve shtetërore, që kanë kompetenca vendimmarrëse të njohura me ligj për trashëgiminë e pronave".*<br>*Në këto kushte, ju bëjmë me dije se për të bërë të mundur marrjen e një informacioni të detajuar si dhe vënien në dispozicion të kopjes së vendimit të sipërcituar, në mbështetje të Neneve 44, 45, 65 te Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" të Republikës së* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *Shipërisë, nga ana juaj duhet që kërkesa të jetë e shoqëruar sipas rastit* ***me prokurë përfaqësimi, dëshmi trashëgimie, si dhe cdo dokument tjeter të nevojshëm për të provuar interesin tuaj të ligjshëm në cilësinë e personit të interesuar në këte kërkim, i cili duhet të jetë origjinal ose i njëhsuar me originalin.*** | | |
| 15 | 21.06.2024 | Kerkoj informacion mbi buxhetin e ATP sipas zerave te caktuara. | 26.06.2024 | Informacioni i kerkuar mund te aksesohet edhe tek fq zyrtare e ATP, programi transparences,informacion mbi buxhetin dhe te dhenat financiare. | E plote | Jo |
| 16 | 24.06.2024 | Informacion per subjektin e shpronesuar DH.Z etj si dhe pretendime ne lidhje me regjistrim e pasurive. | 01.07.2024 | Ne lidhje me informacionin e kerkuar ju informojme se *në mbështetje të Neneve 44, 45, 65 te Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" të Republikës së Shipërisë, nga ana juaj duhet që kërkesa të jetë e shoqëruar sipas rastit* ***me prokurë përfaqësimi, dëshmi trashëgimie, si dhe cdo dokument tjeter të nevojshëm për të provuar interesin tuaj të ligjshëm në cilësinë e personit të interesuar në*** | E pjesshme | jo |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ***këte kërkim, i cili duhet të jetë origjinal ose i njëhsuar me originalin.***<br><br>Gjithashtu ATP kryen detyrat dhe ushtron pergjegjesite ne perputhje me percaktimet e ligjit 133/2015. Ndersa per zgjidhjen e problematikave te pretenduara ju mund ti drejtoheni organeve kompetente. | | |